



This project is funded
by the European Union



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

INSTAT
Republika e Shqipërisë
Instituti i Statistikës

S H Q I P Ë R I | A L B A N I A

Rezultatet Kryesore

CENSUS I POPULATION POPULLSISË AND HOUSING DHE BANESAVE CENSUS

Main Results

P j e s a 1 | P a r t 1

2011



CENSUSI I POPULLSISË DHE BANESAVE 2011

POPULATION AND HOUSING CENSUS 2011

Drejtor Botimi Ph.D Ines NURJA

INSTAT

Alma Kondi
Altin Xhikneli
Anisa Omuri
Blerina Subashi
Elda Kapllani
Emira Galanxhi
Ervin Shameti
Fatjona Pupuleku
Ledia Thomo
Majlinda Nesturi
Nurije Çaushti
Ogerta Elezaj
Olgeta Dhono
Ruzhdie Bici
Teranda Jahja
Valbona Petoshati

ASISTENCA TEKNIKE

Alessandro Gori
Bart de Brujin
Donatela Zindato
Ed Swires-Hennessy
Giambattista Cantisani
Guido Pieraccini
Jan Bartlema
Jeannette Schoorl
Patrick Simon
Roberto Bianchini
Shaban Sinani

Copyright © INSTAT 2012

Ndalohet riprodhimi i këtij botimi apo transmetimi i tij në cilëndo formë, pa autorizim paraprak me shkrim të mbajtësit të së drejtës së autorit.

No part of this publication can be reproduced or transmitted in any form or by any means without the prior written permission of the copyright holder

Faqosje: Gjergji KOLLUMBI, Mariana VLLAU

INSTAT
INSTITUTI I STATISTIKES,
Blv. "Zhan D'Ark" Nr. 3, Tiranë
Tel : + 355 4 2222411 / 2233356
Fax : + 355 4 2228300
E-mail : info@instat.gov.al

Shtypshkronja "Adel Print"

Parathënie dhe falenderime

Preface and acknowledgements

Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011 është i 11-i census i kryer në historinë e Shqipërisë. Mbi bazën e rezultateve të censusit, tashmë të dhënat e përditësuara sociale dhe ekonomike, mund të përdoren për planifikimin dhe vlerësimin e politikave të ndryshme qeveritare, si dhe të programeve të zhvillimit në nivel qendror dhe vendor. Përgatitja dhe kryerja e operacioneve të censusit kërkoj angazhimin e një vëllimi të madh burimesh financiare, njerëzore dhe materiale të mbështetura nga Qeveria e Shqipërisë, Komisioni Europian dhe donatorë të huaj. Metodologjia e censusit është bazuar në rekomandimet e Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe të zyrës statistikore të Bashkimit Europian (EUROSTAT) për raundin 2010 të censuseve të popullsisë dhe banesave. Në këtë proces janë marrë në konsideratë nevojat specifike të përdoruesve të të dhënave në Shqipëri. Organizimi dhe funksionimi i procesit të censusit është mbështetur në Ligjin nr. 10444, datë 07.07.2011 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8669, datë 26.10.2000 "Për censusin e përgjithshëm të popullsisë dhe banesave", (të ndryshuar). Komisioni Qendror i Censusit dhe komisionet vendore të censusit bazuar në ligjgarantuan infrastrukturën dhe lehtësirat e nevojshme për realizimin e tij. Mbrojtja e konfidencialitetit të të dhënave garantohet nga Ligji për statistikat zyrtare nr. 9180, datë 5.2.2004, neni 15, mbi konfidencialitetin, dhe në të njëjtën kohë edhe nga Ligji "Mbi ruajtjen e të dhënave personale" nr. 9887, datë 10.03.2008, neni 9. Zyrtarisht numërimi filloi në mesnatën e 30 shtatorit 2011 dhe, ashtu siç ishte përcaktuar në ligjin e censusit, zgjati një muaj në terren, me qëllim mbledhjen e informacionit të saktë në të gjithë vendin. Një nga risitë në aspektin teknik të Censusit të Popullsisë dhe Banesave 2011 në Shqipëri ishte dhe përdorimi i teknologjive të avancuara për leximin automatik të të dhënave, nëpërmjet përdorimit të njohjes inteligjente të karaktereve (ICR). Për herë të parë në historinë e censuseve të realizuara në Shqipëri, INSTAT kreu anketën e pas censusit për të matur mbulimin e censusit dhe cilësinë e të dhënave për kategoritë e zgjedhura. Informimi dhe ndërgjegjësimi i popullsisë për të marrë pjesë në census u realizua nëpërmjet strategjisë së komunikimit, si dhe planit të detajuar për mediat, aktivitetet e të cilave mbulonin të gjitha kategoritë e shoqërisë shqiptare. Publikimi i rezultateve kryesore është pjesë e produkteve të censusit. Ai mbështetet në strategjinë e publikimeve dhe planin e tabulimeve që INSTAT ka përgatitur. Këto dy dokumente janë përgatitur mbi bazën e nevojave në vend për të dhëna socio-ekonomike, si dhe me qëllimin

The 2011 Albanian Population and Housing Census, is the 11th census conducted in the history of Albania. With the availability of census results, the country can now use up-to-date socio-economic data for planning and evaluating various government policies and intervention programmes at national, regional and local levels.

The preparation and implementation of the census operations required a large amount of financial, human, and material resources which were supported by the Albanian government, the European Union and international donors.

The methodology was based on the Eurostat and UN recommendations for the 2010 Round of Population and Housing Censuses, taking into consideration the specific needs of Albanian data users.

The organisation and functioning of the census process was based on the Law No. 10444, dated 07.07.2011 "On some amendments and additions to the Law No. 8669, dated 26.10.2000 "On the general Census of Population and Housing" (as amended). The central census commission and local census commissions in municipalities and communes were ensuring the proper institutional infrastructure and facilities for the conduction of census operations.

The protection of data confidentiality is ensured both by the law No. 9180, dated 5.2.2004, "On official statistics", in accordance with article 15, "On Confidentiality", and law No. 9887 dated 10.03.2008 "On the protection of personal data", article 9.

Officially the enumeration started on the census night on September 30, 2011, and as defined per the census law it lasted one month in the field with the purpose of collecting accurate information all over the country. One of the innovative technical aspects of the Albanian 2011 Population and Housing Census was the use of advanced technologies such as Intelligent Character Recognition (ICR) for data capture. For the first time in the history of the censuses conducted in Albania, INSTAT has carried out a post enumeration survey with the purpose of evaluating the census coverage and data quality for selected variables.

As for the information and awareness of the population to participate in the census, a communication strategy was prepared as well as a detailed media plan covering the entire Albanian society.

The publication of the main results is part of the census outputs included in the dissemination strategy and tabulation plan that INSTAT has prepared. These documents have been defined on the basis of Albanian

për të siguruar krahasueshmërinë dhe koherencën e të dhënave me ato të vendeve të tjerë, me censuset e mëparshëm dhe anketa të tjera.

Ky botim përmban pjesën e parë të rezultateve të censusit dhe përfshin treguesit kryesorë mbi demografinë, arsimin, ndërtesat e banesat, aftësinë e kufizuar, si dhe përkatësinë etno-kulturore dhe ajo fetare në nivel kombëtar dhe rajonal. Ai do të pasohet me pjesën e dytë e cila do të ketë të dhëna mbi karakteristikat ekonomike të popullsisë. Në vijim, INSTAT do të botojë rezultatet e censusit në 12 qarqe të cilat do të vijojnë me botimin e analizave dhe studimeve për tematika të ndryshme si projeksionet e popullsisë, kushtet e banimit dhe nivelit të jetesës, rinia dhe arsimi, tregu i punës, shëndeti, transporti dhe lëvizja e popullsisë, etj. Gjithashtu pjesë e publikimeve do të jetë edhe atlas i censusit.

INSTAT dhe qeveria shqiptare dëshiron t'i shprehë falenderime dhe mirënjohje për kontributin e tyre të çmuar: Bashkimit Europian nëpërmjet EUROSTAT dhe Delegacionit të Bashkimit Europian në Shqipëri, Organizatës së Kombeve të Bashkuara nëpërmjet nismës "Një OKB", qeverisë suedeze nëpërmjet SIDA, qeverisë zviceriane nëpërmjet SDC.

INSTAT falenderon Komisionin Qendror të Censusit, i cili ka qenë efikas në vendimmarrje për të kryer këtë proces në kohë dhe me logjistikën e nevojshme.

Gjithashtu një falenderim i veçantë rezervohet për Asistencën Teknike të BE-së për censusin. Me ekspertët e saj është punuar ngushtësisht dhe ndihma e ofruar ka qenë jo vetëm në kryerjen me sukses të këtij censusi, por edhe në rritjen e kapaciteve profesionale të stafit të INSTAT.

Gjej rastin të falenderoj për zemërsisht stafin e INSTAT, i cili ka punuar me përkushtimin maksimal dhe profesionalizëm për realizimin me sukses të Censusit të Popullsisë dhe Banesave 2011.

needs of socio-economic data and, in order to ensure comparability and coherence with data produced in Albania and other countries, on the basis of past censuses and other surveys.

This publication contains the first part of the census results and includes the main figures about demography, education, disability, housing and households, ethnic and religion affiliation at national and prefecture levels. The second part of census results will disseminate data on economic characteristics. The next series of publication will focus on data for the twelve prefectures, to be followed by in-depth analysis of thematic topics such as population projections, housing and living conditions, youth and education, labour market, health, transport and mobility. A census atlas will be also prepared and disseminated.

INSTAT and the Albanian government would like to express the gratitude and acknowledgments for their valuable contribution to: the EU through Eurostat and the EUD to Albania, the UN through One UN programme, the Swedish government through SIDA and the Swiss government through SDC.

INSTAT recognises with appreciation the contribution of the central census commission as a key factor for the success of the census in terms of institutional support provided and efficient and prompt decision-making.

Moreover, a special gratitude goes to the EU technical assistance team which has worked closely with INSTAT. Their support was important not only in the successful implementation of the census but in the transfer of knowledge and capacity building of INSTAT staff as well.

I would take this opportunity to cordially thank the INSTAT staff that has worked with strong commitment and professionalism for a successful implementation of the census process.

PhD. Ines Nurja

Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT
Director General of INSTAT



PËRMBAJTJA | CONTENTS

Parathënie dhe falenderime Preface and acknowledgements	3
Gjetjet kryesore Main findings	7
Anketa e pas censusit në Shqipëri, 2011 The Albanian Post Enumeration Survey, 2011	21
Shënime metodologjike Methodological note	27
Tabelat Tables	41
Harta tematike Thematic maps	167

Lista e akronimeve

Abbreviations

Lista e Akronimeve Abbreviations	Përkufizimi	Definition
KSE/CES	Konferenca e Statisticienëve Europeanë	Conference of European Statisticians
ZC/EA	Zonë Censusi	Enumeration Area
BE/EU	Bashkimi Europian	European Union
EUD	Delegacioni i Bashkimit Europian në Republikën e Shqipërisë	Delegation of the European Union to the Republic of Albania
EUROSTAT	Zyra statistikore e Bashkimit Europian	Statistical Office of the European Union
GIS	Sistemi i Informacionit Gjeografik	Geographic Information System
ICR	Njohja Inteligjente e Karaktereve	Intelligent Character Recognition
INSTAT	Instituti i Statistikave	National Institute of Statistics of Albania
ISCED	Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Arsimit	International Standard Classification of Education
NJEF	Njësi Ekonomike Familjare	Private Household
NSO	Zyra Statistikore Kombëtare	National Statistical Office
APC/PES	Anketa e Pas Censurit	Post Enumeration Survey
SMS	Shërbimi i mesazheve nëpërmjet celularëve	Short Message Service from Mobile Phones
SDC	Agjencia Zviceriane për Zhvillimin dhe Bashkëpunim	Swiss Development Cooperation Office
SIDA	Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim	Swedish International Development Cooperation Agency
UN	Organizata e Kombeve të Bashkuara	United Nations

GJETJET KRYESORE

MAIN FINDINGS

Popullsia

Më 1 tetor 2011 popullsia banuese e Shqipërisë ishte 2 821 977 banorë. Vihet re një rënie në numrin e popullsisë afërsisht prej 8,0% në krahasim me Censusin e vitit 2001, ku popullsia e numëruar ishte 3 069 275 banorë.

Dinamikat e popullsisë përcaktohen nga katër faktorë: lindjet, vdekjet, imigracioni dhe emigracioni. Efekti i secilit prej faktorëve në numrin e popullsisë jepet në ekuacionin e bilancit të popullsisë:

$$P_{2011} = P_{2001} + L - V + I - E,$$

ku P_{2011} dhe P_{2001} janë respektivisht numri i popullsisë sipas Censurit 2011 dhe 2001 dhe L , V , I dhe E janë lindjet, vdekjet, imigrantët dhe emigrantët në periudhën 2001-2011.

Gjatë periudhës midis dy censuseve (2001-2011) numri i lindjeve ka pësuar rënie të ndjeshme çdo vit, nga rreth 53 mijë në 2001 në rreth 34 mijë në vitin 2011. Ndërkohë, numri i vdekjeve ka mbetur në nivele të qëndrueshme, rreth 20 mijë çdo vit. Kjo nënkupton një shtesë pozitive natyrore, e cila karakterizohet nga një prirje në rënie. Në këto kushte rënia e lindshmërisë mendohet të jetë një nga faktorët që ka influencuar në rënien e numrit të popullsisë.

Duke filluar nga viti 1990 popullsia e Shqipërisë filloi të njihte rënie të konsiderueshme, e cila erdhi si pasojë e emigracionit masiv. Ky fenomen vazhdoi të mbetet veprues dhe gjatë 10 vjeçarit të fundit. Vlerësohet se gjatë periudhës midis dy censuseve të fundit kanë emigruar rreth 500 mijë persona. Ky fakt mbështetet edhe nga të dhënat e emigracionit të marra nga disa prej vendeve kryesore destinacion të emigrantëve shqiptarë si për numrin ashtu edhe për lëvizjet vjetore të tyre.

Grafiku 1 paraqet piramidën e popullsisë në Censurin 2011 dhe Censurin 2001 të spostuar me 10 vjet. Në grafik shihet qartë se një pjesë e konsiderueshme e popullsisë së Censurit 2001, që sot është në moshën 20-45 vjeç, nuk përfshihet në popullsinë banuese të Censurit 2011. Kjo diferencë i dedikohet mbi të gjitha emigracionit që kryesisht ndikon më shumë këto moshë. Piramida tregon gjithashtu se numri i fëmijëve të moshës 0-9 vjeç që i është shtuar popullsisë gjatë 10 viteve përpara Censurit 2011 është shumë më i vogël se ai i fëmijëve të moshës 0-9 vjeç të lindur gjatë 10 viteve para Censurit 2001.

Population

On 1 October 2011, the usually resident population in Albania was 2 821 977. The population has declined around 8.0 per cent, compared to the 2001 census, where the enumerated population was 3 069 275.

Population dynamics are determined by four factors: births, deaths, immigration and emigration. The effect of each factor in the size of population is given by the population balance equation:

$$P_{2011} = P_{2001} + B - D + I - E,$$


where P_{2011} and P_{2001} are, respectively, the population according to census 2011 and 2001, and B , D , I and E are Births, Deaths, Immigrants and Emigrants during the period 2001-2011.

During the inter-censal period 2001-2011 the number of births per year has decreased significantly, from about 53 thousand in 2001 to about 34 thousand in 2011, while the number of deaths per year has remained stable at around 20 thousand. This means a positive natural increase which is characterized by a declining trend. Under these conditions, the decline of fertility is supposed to be one of the factors that was involved in the population decline.

The population of Albania started to decline from 1990, as a consequence of a massive emigration. During the inter-censal period 2001-2011 is estimated that around 500 thousand persons emigrated. This fact is also supported by available migration data obtained from some of the main destination countries of Albanian emigrants, in terms of both stock and flow data.

Figure 1 presents the population pyramid of 2011 and that of 2001 shifted 10 years upward. This shows that a significant part of the 2001 population that is now in the age range 20-45 is no longer included in the resident population. The difference is largely due to emigration, which typically occurs in this age bracket. The figure also shows that the number of children aged 0-9 that has been added to the population in ten years before the 2011 census is much smaller than the corresponding number that was born in the ten years before the 2001 census.


Grafiku 1. Piramidat e popullsisë sipas Censurit 2001 dhe 2011
Figure 1. Population pyramids according to 2001 and 2011 Censuses



Raporti gjinor natyror në lindje (numri i meshkujve për 100 femra) në botë është 105, ndërkohë që ky raport për Shqipërinë është 107,8. Rënia më e madhe e këtij treguesi (grafiku 2.) është pas moshës 80 vjeç. Kjo pasi femrat karakterizohen nga një jetëgjatësi më e lartë se e meshkujve.

The natural sex ratio at birth (the number of males per 100 females) is worldwide 105, while for Albania was 107.8. As shown in Figure 2, the major decrease of the sex ratio is after age 80, which is a common phenomenon as women have a higher life expectancy than men.

Grafiku 2. Raporti gjinor sipas grupmoshave
Figure 2. Sex ratio by age group



Mosha mesatare e popullsisë banuese është rritur nga 30,6 vjeç në vitin 2001 në 35,3 vjeç në vitin 2011. Indeksi i moshës së vjetër, (raporti i popullsisë mbi 65 vjeç ndaj popullsisë gjithsej), është më i lartë se në çdo census të mëparshëm të kryer në Shqipëri. Ky tregues është rritur nga 8% në 2001 në 11% në 2011.

Indeksi i zëvendësimit, (raporti i popullsisë nën 15 vjeç ndaj popullsisë gjithsej), është ulur nga 29.0% në Censusin 2001 në 21% në Censusin 2011, gjë që tregon fillimin e mplakjes së popullsisë.

Qarku i Kukësit ka vlerën më të lartë të koeficientit të varësisë së të rinjve krahasuar me qarqet e tjerë. Në këtë qark popullsia 0-14 vjeç ndaj popullsisë 15-64 vjeç është përkatësisht 43,2%.


The average age of the population increased from 30.6 years in 2001 to 35.3 in 2011. The old-age index, the proportion of population 65 years and over divided by total population, is higher than in any previous Albanian censuses; this value increased from 8.0 per cent in 2001 to 11.0 per cent in 2011.

The substitution index, the proportion of the population under 15 years old divided by the total population, is reduced from 29.0 per cent in 2001 to 21.0 per cent in 2011.

The prefecture of Kukës has the highest overall value of the youth-dependency ratio, population 0-14 years old divided by the population 15-64 years old, which is 43.2 per cent.

Grafiku 3. Koeficienti i varësisë së të rinjve sipas qarkut

Figure 3. Youth dependency ratio by prefecture




Qarku i Gjirokastrës ka vlerën më të lartë përsa i përket koeficientit të varësisë së të moshuarve: popullsia 65+ vjeç ndaj popullsisë 15-64 vjeç, prej 23,8 %.

The prefecture of Gjirokastrë has the highest value in terms of old-age-dependency ratio, population 65 and over years old divided by the population 15-64 years old, which is 23.8 per cent.

Grafiku 4. Koeficienti i varësisë së të moshuarve sipas qarkut

Figure 4. Old dependency ratio by prefecture




Për herë të parë, popullsia që jeton në zonën urbane e ka tejkaluar numrin e popullsisë që jeton në zonën rurale. Popullsia banuese në zonën urbane është 53,5% dhe 46,5% e popullsisë jeton në zonën rurale.

For the first time, the population living in urban areas has exceeded the population living in rural areas. The resident population in urban areas was 53.5 per cent while 46.5 per cent of the population lived in rural areas.

Grafiku 5. Popullsia sipas zonës urbane dhe rurale


Figure 5. Population in urban and rural area



Kjo dëshmon se lëvizjet e brendshme të popullsisë kanë vazhduar me ritme të larta gjatë periudhës 2001-2011 kryesisht nga zona rurale në zona urbane. Krahasuar me censusin e mëparshëm, rreth 10,6 % e popullsisë banuese ka ndryshuar vendbanimin e zakonshëm brenda vendit, ndërkohë 4,0 % deklaroi se në censusin e mëparshëm kanë qenë jashtë vendit.

This shows that internal population movements have continued at high levels during the intercensal period 2001-2011 mainly from rural areas to urban areas. In comparison to the previous census, about 10.6 per cent of the resident population has changed the place of usual residence within the country, while 4.0 per cent declared that at the date of the previous census they were abroad.

Grafiku 6. Popullsia banuese sipas vendbanimit në Censusin 2001
Figure 6. Population according to the usual residence of Census 2001



Dendësia e popullsisë në shkallë vendi është zvogëluar nga 107 banorë për km² në 2001 në 97 banorë për km² në 2011. Qarku i Tiranës dhe ai i Durrësit shënojnë vlerat më të larta krahasuar me qarqet e tjera: respektivisht 454 dhe 343 banorë/km². Kjo ka ardhur si pasojë e rritjes së numrit të popullsisë për shkak të fluksit të lartë të lëvizjeve të brendshme në drejtim të këtyre qarqeve.

The average population density across the whole country reduced from 107 persons per square kilometer in 2001 to 97 persons per square kilometer in 2011. The population density in the prefectures of Tirana and Durrës indicates higher values compared to other prefectures, respectively 454 and 343 persons per square kilometer, due to the increase of population because of high flows internal movements towards these prefectures.

Numri i NjEF-ve në Censusin 2011 është 722 262. Kjo përfaqëson një rënie në vlerë absolute prej 4 633 NjEF-ve ose 0,6% krahasuar me censusin e mëparshëm. Madhësia mesatare e NjEF-së është zvogëluar nga 4,2 anëtarë në 2001 në 3,9 anëtarë në 2011. Në zonat urbane ky tregues është 3,6, ndërsa në zonat rurale treguesi është 4,2 anëtarë për NjEF. Qarku i Kukësit ka vlerën më të lartë, prej 5,0 anëtarësh, ndërkohë që qarku i Gjirokastrës ka vlerën më të vogël, prej 3,4 anëtarësh.

The number of private households is 722 262. This represents a decrease in the absolute number of households by 4 633 units or 0.6 per cent compared to the previous census. The average size of a household declined from 4.2 in 2001 to 3.9 members in 2011. In urban areas this indicator is 3.6, while in rural areas it is 4.2 household members. The prefecture of Kukës has the highest figure, 5.0, while the prefectures of Gjirokastrë has the lowest figure with 3.4 household members.

Arsimi

Sistemi arsimor në Shqipëri është publik dhe privat. Vitet e fundit sistemi arsimor i vendit ka pasur një sërë ndryshimesh për të pasur një përfaqje me sistemet europiane të arsimit. Zhvillime ka patur sidomos në nivelet e arsimit të lartë. Përveç universiteteve publike, një sërë universitetesh private janë hapur në qytetet kryesore të vendit. Në nivelin universitar, është duke u aplikuar sistemi i Bolonjës (3+2) nga të gjithë universitetet publike dhe private. Në bazë të legjislacionit në fuqi, dy nivelet e para të arsimit bazë, arsimi fillor dhe aktualisht arsimi 9-vjeçar (klasat nga 1-9) janë arsim i detyrueshëm në Shqipëri.

Në Censusin 2011 u përfshinë katër pyetje për karakteristikat e arsimit, duke marrë informacion mbi analfabetizmin, ndjekjen e arsimit, diplomën më të lartë të marrë, si dhe vitet e arsimit të përfunduar. Këto pyetje u përfshinë për të ruajtur krahasueshmërinë me Censusin 2001 dhe për të bërë të mundur llogaritjen e treguesve kryesorë të arsimit.

Nga të dhënat e Censurit 2011 u vu re se niveli i analfabetizmit për popullsinë 10 vjeç e lart është 2,8%. Kjo normë është e ndikuar nga niveli i lartë i analfabetizmit për grupmoshat më të mëdha se 75 vjeç, të cilët përbëjnë rreth 50% të totalit të analfabetëve, e cila është në përputhje me përqindjen që zënë grupmoshat e mëdha në totalin e popullsisë. Përqindja e analfabetëve është më e lartë te femrat 3,7% sesa te meshkujt 1,7%.

Education

Education in Albania is covered by public and private schools. In recent years, the Albanian education system has made substantial progress towards the general compliance with other European educational systems. The progress has been made particularly at the tertiary levels of education. In addition to public universities, a number of private universities have been opened in the main cities of the country thus giving students the opportunity to study in various branches. At university level, the Bologna system (3+2 years) is nowadays followed by all universities, public and private.


According to the legislation, the first two levels of education, primary and lower secondary (grades 1-9), are currently compulsory in the country.

The census 2011 included four questions on educational characteristics taking information for literacy, educational attainment, highest diploma obtained and completed years of education. These questions were included to maintain comparability with data from the 2001 census and enabling the calculation of key indicators on education.

Data from the 2011 census show that the illiteracy rate for the population 10 years and over is 2.8 per cent. This relatively high rate is nowadays affected by the relatively large number of illiterates in the ages 75 years and over who constitute about 50 per cent of the total illiterate people, in combination with the increased share of this elderly age group in the total population. The percentage of illiterates is higher in women, 3.7 per cent, than in males, 1.7 per cent.

Grafiku 7. Përqindja analfabete e popullsisë 10 vjeç e lart sipas qarqeve

Figure 7. Percentage of illiterate on population aged 10 years and over by prefecture



Grafiku 7 paraqet nivelin e analfabetizmit sipas qarqeve për popullsinë 10 vjeç e lart mbi totalin e kësaj popullsie. Qarku i Tiranës, ndjekur nga ai i Kukësit dhe më pas i Durrësit ka nivelin më të ulët të analfabetizmit, ndërsa qarku i Lezhës dhe i Elbasanit ka nivelin më të lartë të saj.

Popullsia 10 vjeç e lart që është duke ndjekur ose ka ndjekur shkollën është 2 361 718, ose 96,2% të popullsisë 10 vjeç e lart. Në Censusin 2011, rreth 262 369 persona kanë përfunduar ose janë duke ndjekur nivelet universitar dhe pasuniversitar. Kjo përbën 10,7% të popullsisë 10 vjeç e lart, duke shënuar rritje të ndjeshme krahasuar me Censusin 2001 (5,5%).

Përqindjen më të lartë të individëve me të paktën një diplomë universitare e kanë qarqet e Tiranës, Vlorës dhe Gjirokastrës. Qarqet që kanë përqindjen më të ulët të individëve që kanë të paktën një diplomë universitare janë Dibra dhe Lezha. Grafiku 8 sintetizon të dhënat për ndjekjen e shkollës si dhe diplomën më të lartë të marrë sipas gjinisë. Përqindja e femrave me të paktën diplomë universitare është shumë pak mbi mesataren (51,0%). Në 2001 shumica e individëve me të paktën një diplomë universitare përbëhej nga meshkujt (58,9%) dhe femrat vetëm 41,1%.

Figure 7 reflects the illiteracy rates of the population 10 years and over by prefecture. Tirana prefecture followed by the prefectures of Durrës and Kukës had the lowest rate of illiteracy and the prefectures of Lezha and Elbasan had the highest.


The population aged 10 years and over who are currently attending or have completed school is 2 361 718 or 96.2 per cent of the population 10 years and over. In the 2011 census, 262 369 persons have completed or are attending university or post-graduated levels. The population with tertiary education is about 10.7 per cent of the total population 10 years and over, a significant increase from the 2001 census, 5.5 per cent.

The prefectures that have the highest percentages with at least a university diploma are Tirana, Vlorë and Gjirokastra. Prefectures that have the lowest percentages of individuals with at least a university degree are Dibra and Lezha.

Figure 8 shows school attendance and diploma levels by sex. Among persons with at least university degree, slightly over half, 51.0 per cent are women. In 2001 the majority still consisted of men, 58.9 per cent with only 41.1 per cent women.

Grafiku 8. Ndjekja e shkollës për popullsinë 15 vjeç e lart sipas gjinisë

Figure 8. Education attendance for population aged 15 years and over by sex



Në shpërndarjen e popullsisë 10 vjeç e lart sipas diplomës më të lartë të marrë vihet re se 14,9% kanë përfunduar arsimin fillor, 40,9% arsimin 7/8/9 vjeçar dhe 28,4% kanë arsimin e mesëm, përfshirë gjimnazin dhe shkollat profesionale.

Ndërmjet atyre që kanë përfunduar arsimin fillor, femrat kanë përqindje më të lartë (53,4%) krahasuar me meshkujt (46,6%). Për arsimin e mesëm, shpërndarja gjinore ka kah të kundërt, janë mesh-

The distribution of the population 10 years and over by highest level of education attained shows that 14.9 per cent has primary school as the highest level, 40.9 per cent has lower secondary school as the highest level, and 28.4 per cent attained upper secondary education, including general or vocational schools. Among those with only primary education, women are overrepresented with 53.4 per cent, compared to 46.6 per cent for men. For upper secondary educa-

kujt ata që kanë përqindjen më të lartë (55,5%) ndaj 44,5% të femrave.

Të dhënat e censurit tregojnë se ndjekja e shkollës në Shqipëri është në nivele të larta, sidomos për grupmoshat e reja shkollore. Në nivel vendi për grupmoshën 7-15 vjeç, vetëm 1,0% e totalit të kësaj grupmoshe nuk kanë ndjekur asnjëherë shkollën.

Numri mesatar i viteve të përfunduara të arsimit për popullsinë 15 vjeç e lart është 10 vite. Të dhënat tregojnë se nuk ka një diferencë për sa i përket ndarjes gjinore. Qarqet Tiranë, Vlorë dhe Gjirokastrë kanë numrin më të lartë të viteve të përfunduara të arsimit për popullsinë 15 vjeç e lart.

Aftësia e kufizuar

Për herë të parë në Shqipëri, Censuri i Popullsisë dhe Banesave 2011 identifikoi personat me kufizime të aktiviteteve bazë të funksionimit (shikim, dëgjim, ecje, kujtesë, kujdesi ndaj vetes dhe komunikim). Objektivi kryesor ishte për të përcaktuar numrin e personave me aftësi të kufizuar, llojin e aftësisë së kufizuar, si dhe profilet e tyre demografike dhe social-ekonomike.

tion, the gender distribution is the opposite: 44.5 per cent for women and 55.5 per cent for men.

Census data show that levels of school attendance in Albania are high, especially for the youngest school-age group. At the country level, only 1.0 per cent of the age group of 7-15 years old never attended school.


The average number of completed years of education for the population 15 years and above is 10 years. There is no difference related to gender for average years of education. Tirana, Vloera and Gjirokastra are the prefectures with the highest average years of education of persons aged 15 years and over.

Disability

The 2011 census identified for the first time the population with limitations in the functioning of basic activities (seeing, hearing, mobility, cognition, self-care and communication). The main objective was to determine the number of persons with disability, type of disability, as well as their demographic and socio-economic profiles.

Grafiku 9. Aftësia e kufizuar sipas grupmoshës dhe gjinisë

Figure 9. Disability by age group and sex



Një total prej 137 435 personash mbi 15 vjeç u raportuan të kenë patur një lloj të aftësisë së kufizuar. Popullsia 15 vjeç e lart me të paktën një aftësi të kufizuar është 6,2%. Nga këta 45,3% janë meshkuj dhe 54,7% femra. Shumica e personave me aftësi të kufizuar kanë deklaruar se kanë vuajtur nga aftësia e kufizuar në ecje dhe në shikim.

Gratë me aftësi të kufizuar kanë tendencë që të

For a total of 137 435 people it was reported that they had some sort of disability. The percentage of disabled population 15 and over with at least one type of disability was 6.2 per cent, and from these 45.3 per cent were males and 54.7 per cent females. Most of the people who reported disabilities stated that they have problems with mobility and seeing. The disability propensity was higher in women

kenë një normë më të lartë në krahasim me burrat. Kjo duket sidomos në rezultatet e gjendjes së statusit civil, ku prevalencën më të lartë e kanë gratë e martuara dhe ato të veja. Faktori më i rëndësishëm është fakti që aftësia e kufizuar është më e lartë në moshat e vjetra dhe personat me moshë të vjetër më së shumti janë femra (shih grafikun 9).

Në nivel qarku, prevalencën më të lartë të aftësisë së kufizuar e ka Gjirokastra me 8,0%. Kjo për shkak se popullsia 65 vjeç e lart në këtë qark është më e larta në rang vendi. Ndërsa prevalenca më e ulët e aftësisë së kufizuar vihet re në qarkun e Tiranës, me 4,8% të popullsisë mbi 15 vjeç.

Prevalenca ndryshon nga grupmosha e popullsisë dhe qarku. Prirja e saj është të rritet me moshën, kryesisht mbi moshën 50 vjeç.

Krahasimi i numrit të personave me aftësi të kufizuar (atyre që kanë shumë vështirësi ose nuk mundën fare të kryejnë aktivitetet bazë të funksionimit) me nivelin arsimor të arritur tregon se 1,9% e popullsisë 15 vjeç e lart me aftësi të kufizuar, që kanë ndjekur ose janë duke ndjekur shkollën janë pa diplomë, nga të cilët 40,4% janë meshkuj dhe 59,6% janë femra dhe kjo aftësi e kufizuar rritet me rritjen e moshës.

Rezultatet e censusit treguan se 55,6% e popullsisë 15 vjeç e lart me aftësi të kufizuar kanë përfunduar arsimin bazë dhe 3,3% janë me arsim të lartë dhe pasuniversitar, ndërsa 24,3% nuk e kanë ndjekur asnjëherë shkollën.

Njësitë Ekonomike Familjare

Në momentin e Censusit, numri i NjEF-ve në Shqipëri ishte 722 262 nga të cilat 56,7% në zonën urbane dhe 43,3% në zonën rurale.

Rreth 90,2% e NjEF-ve të numëruara janë: pronarë të banesës në të cilën jetojnë ose duke paguar kredi apo në procesin e marrjes së aktit të pronësisë. Qiramarrës janë 5,7% e totalit të NjEF-ve të përqëndruar kryesisht në zonën urbane.

Sistemi i ngrohjes në Shqipëri përbëhet kryesisht nga pajisjet ngrohëse të veçanta si soba, e zotëruar nga 63,3% e NjEF-ve, kondicioneri, ngrohësi elektrik etj, ndërsa ngrohjen qendrore brenda ndërtesës apo banesës e zotërojnë vetëm 3,2% të NjEF-ve.

Drutë e zjarrit vazhdojnë të jenë lloji kryesor i energjisë për ngrohje për 57,5% të NjEF-ve, ndjekur nga gazi (20,8%) dhe më pas nga energjia elektrike (15,4%). Megjithatë, në krahasim me Censusin 2001 numri i NjEF-ve që përdorte si lloj kryesor të energjisë për ngrohje drutë e zjarrit ka pësuar rënie me 12,3 %.

compared to men. This characteristic seems dependant on the civil status, with higher prevalence in the married women and widows. The most important factor is likely to be the fact that disability is directly related to old age and old age persons are more likely women (see figure 9).

At the prefecture level, the highest prevalence was in Gjirokastra with 8 per cent, where there was also a high percentage of population aged 65 years and more. The lowest prevalence of disability was in the prefecture of Tirana, 4.8 per cent of the persons aged 15 and over. The prevalence varied by prefecture and by age group, especially for those aged over 50 years.

The comparison between people with severe disabilities (those having a lot of problems or being completely unable to perform a body function) and the educational level achieved indicates that 1.9 per cent of disabled population aged 15 years and over who have attended or are attending school were without diploma, of whom 40.4 per cent were men and 59.6 per cent were women, and that the disability increased with age.

Census data shows that 55.6 per cent of disabled population 15 and over had completed basic education and 3.3 per cent had completed tertiary and post-graduate education, while 24.3 per cent had never attended school.

Households

At the time of the census, the number of private households in Albania was 722 262 of which 56.7 per cent were located in urban areas and 43.3 per cent in rural areas. About 90.2 per cent of the enumerated private households owned the dwelling where they lived, or were paying a mortgage, a loan or were in the process to acquire the legal act of ownership. Some 5.7 per cent of the total households rented their dwelling, mainly in urban areas. Heating systems in Albania consist mainly of separate equipment like stoves, owned by 63.3 per cent of the households, air conditioners, or electric heaters, while central heating systems within the building or the dwelling were owned only by 3.2 per cent of households.

Firewood continued to be the main type of heating for 57.5 per cent of the households, followed by gas, 20.8 per cent and by electricity, 15.4 per cent. In comparison with 2001, the use of firewood has

Ndërsa, është rritur me 14,9% numri i NjEF-ve që përdorin gaz. Në Censusin 2001, janë regjistruar rreth 30% e NjEF-ve që përdornin energjinë elektrike, gjë që tregon një ulje prej rreth 50% të përdorimit të energjisë elektrike për ngrohje.

Në zonën rurale përdorimi i druve të zjarrit është ende masiv, rreth 85,0% e NjEF-ve e kanë atë llojin kryesor për ngrohje, ndërsa një përqindje mjaft e vogël, 7,1% përdor gazin dhe akoma më pak energjinë elektrike, 4,1%.


Përkundër, në zonën urbane, shpërndarja e NjEF-ve sipas llojit të energjisë së përdorur për ngrohje është më e balancuar: rreth 36,3% e NjEF-ve ngrohen me dru, 24,0% me energji elektrike dhe 31,3% me gaz.

Shpërndarja e NjEF-ve sipas llojit kryesor të energjisë së përdorur për ngrohje në zonat urbane dhe rurale ilustruhet nga grafiku i mëposhtëm:

decreased by 12.3 per cent, while has increased the number of households using gas for heating by 14.9 per cent. In the 2001 census about 30 per cent of the households used electricity, which shows a reduction by 50.0 per cent on the use of electricity for heating. In rural areas, the use of firewood is still massive - about 85.0 per cent of households - while 7.1 per cent use gas and less, electricity, about 4.1 per cent. In urban areas, the distribution of households by main type of energy used for heating was more balanced: about 36.3 per cent of households are heated with wood, 24.0 per cent with electricity and 31.3 per cent with gas.

The distribution of households by main type of energy used for heating in urban and rural areas is represented in the figure below:

Grafiku. 10 Njësitë Ekonomike Familjare sipas llojit kryesor të energjisë së përdorur për ngrohje dhe zonës urbane dhe rurale
Figure. 10 Private households by main type of energy used for heating in urban and rural area



Pothuajse të gjitha NjEF-të në Shqipëri kanë në zotërim pajisje afatgjata bazë si: televizorë 92,4%, frigoriferë 92,4% dhe lavatriçe 80,2%. Në krahasim me vitin 2001 përqindja e NjEF-ve që zotëronin televizorë është pothuajse e njëjtë, ndërsa regjistrohet rritje e ndjeshme lidhur me zotërimin e frigoriferëve dhe lavatriçeve, përqindjet e të cilëve ishin përkatësisht 74,1% dhe 39,3%. Përsa u përket pajisjeve më të reja elektro-shtëpiake, përqindja e NjEF-ve që i zotëron është ende e vogël: 17,6% kanë mikrovalë, 11,3% kanë kondicioner, 3,4% kanë makinë pjatlarëse dhe rreth 3,0% e tyre zotëron tharëse rrobash. Në Censusin 2001, NjEF-të që kishin në zotërim kondicioner apo mikrovalë ishte më pak se 2,0%. Rreth 28,5% e NjEF-ve në Shqipëri kanë linjë të tele-

Almost all households in Albania had available basic amenities such as TV, 92.4 per cent, refrigerators, 92.4 per cent, and washing machines, 80.2 per cent. Compared with 2001, the number of households who owned TV was almost the same, while there is a considerable increase in the number of households that had refrigerators and washing machines, which percentages were respectively 74.1 per cent and 39.3 per cent. However, the percentage of households who owned new electro-domestic equipment is still small, 17.6 per cent have microwaves, 11.3 per cent have air conditioning, 3.4 per cent have a dishwasher and about 3.0 per cent owns a tumble dryer. In 2001, the number of households that had air conditioner or microwave was less than

fonit fiks në banesë, përqëndruar kryesisht në zonat urbane. NjEF-të që kanë të paktën një person që ka në zotërim aparat celular përbëjnë 86,8% të totalit. Rreth 20,0% e NjEF-ve në shkallë vendi kanë në zotërim një kompjuter, nga të cilat 82,3% ndodhen në zonën urbane dhe 17,7% në zonën rurale. Në vitin 2001, numri i NjEF-ve që kishin një kompjuter ishin më pak se 2,0%.

Në Shqipëri, 24,8% e NjEF-ve kanë të paktën një makinë në zotërim në krahasim me censusin 2001 ku kjo përqindje ishte vetëm 8,0%.


Shpërndarja e NjEF-ve sipas zotërimit të pajisjeve afatgjata dhe shërbimeve në zonat urbane dhe rurale pasqyrohet në grafikun e mëposhtëm:

2.0 per cent.

About 28.5 per cent of the households in Albania had a fixed phone line at home, mainly concentrated in urban areas. Some 86.8 per cent of households had at least one member that has a mobile phone. About 20.0 per cent of the households at national level had a computer of which, about 82.3 per cent were located in urban areas and 17.7 per cent in rural areas. In 2001 census, the number of households owning a computer was under 2.0 per cent. A car was available in 24.8 per cent of the households compared with 8.0 per cent in 2001. The figure below shows the distribution of households by amenities in urban and rural areas.

Grafiku. 11 Njësitë Ekonomike Familjare sipas pajisjeve afatgjata, shërbimeve dhe zonës urbane dhe rurale

Figure. 11 Private households by amenities in urban and rural area



Ndërtesat dhe banesat

Numri i ndërtesave për qëllime banimi në Shqipëri në 2011 është 598 267. Ato janë kryesisht shtëpi individuale, mbi 80%, të përbëra nga një kat dhe vetëm me një banesë. Vetëm 3,7% e këtyre ndërtesave janë pallate, prej të cilave 31,3% ndodhen në qarkun e Tiranës. Vetëm 1,0% e totalit të ndërtesave kanë 6 kate e më shumë, ndërsa 2,1% e totalit kanë 9 apo më shumë banesa. Ndërtesat me 2 kate dhe ato me 2 banesa përbëjnë rreth 10,0% të totalit të ndërtesave për qëllime banimi në vend.

Lezha është qarku në të cilin dominojnë ndërtesat me një kat, 91,2%. Ndërsa Tirana është qarku me numrin më të lartë të ndërtesave me mbi 3 kate.

Housing

The number of residential buildings in Albania was 598 267. More than 80 per cent were mainly one storey detached houses, with only one dwelling. Only 3.7 per cent of them were apartment buildings, of which 31.3 per cent were located in the prefecture of Tirana. Only 1.0 per cent of them had 6 floors and more, while 2.1 per cent of the total had 9 dwellings or more. Buildings with 2 floors and buildings with 2 dwellings were about 10.0 per cent of the buildings used for residential purposes.

The prefecture of Lezha had the higher percentage of buildings with one floor, 91.2 per cent, while the prefecture of Tirana had the highest number of

Nga 1,2% e ndërtesave që kanë ashensor, 38,1% e tyre ndodhen në qarkun e Tiranës.

Në Shqipëri numërohen 1 012 400 banesa gjithsej, të cilat, për nga klasifikimi i llojit të tyre, ndahen në banesa të zakonshme, 99,6%, dhe lloj tjetër banese, 0,4%. Ndërsa, për nga klasifikimi “banesa private” dhe “banesa kolektive”, fondi i banesave ndahet përkatësisht në 99,97 dhe 0,03%.

Rreth 57% e të gjithë banesave të banuara (pa përfshirë banesat kolektive) janë të përqëndruara në zonën urbane dhe rreth 43% në zonën rurale. Në krahasim me vitin 2001, ka një rritje të banesave të banuara në zonën urbane, me 24,7% dhe një ulje të numrit të banesave të banuara në zonën rurale, me 20,5%. Në grafikun 12 është pasqyruar shpërndarja e banesave të zakonshme të banuara dhe numri i NjEF-ve sipas qarqeve. Qarku i Tiranës regjistron përqindjen më të madhe ndaj totalit si përsa u përket banesave ashtu dhe NjEF-ve, përkatësisht 26,0% dhe 27,2%. Siç duket edhe nga grafiku, pas Tiranës janë qarku i Fierit, Elbasanit, Durrësit dhe Vlorës, që regjistrojnë përqindjen më të lartë të treguesve të mësipërm në krahasim me qarqet e tjera.

Banesat e pabanuara përbëjnë 21,7% të banesave të zakonshme, prej të cilave 52,6% ndodhen në zonat

buildings with more than 3 floors. Only 1.2 per cent of the residential buildings had an elevator, 38.1 per cent of them were located in Tirana.

There were a total of 1 012 400 dwellings enumerated in Albania, from which, according to the classification by type, 99.6 per cent were conventional dwellings and 0.4 per cent of them were non-conventional ones. The stock of housing can be also analysed by private or collective classification with respective percentages as 99.97 and 0.03.


Some 56.6 per cent of all inhabited dwellings (without collective ones) were concentrated in urban areas and 43.4 per cent in rural areas. Compared with 2001, there was an increased number of inhabited dwellings in urban areas by 24.7 per cent and a decrease in the number of inhabited dwellings in rural areas by 20.5 per cent.

The figure 12 represents the distribution of inhabited conventional dwellings and number of households by prefecture. The prefecture of Tirana had the largest percentage of dwellings and households, 26.0 per cent and 27.2 per cent respectively. As shown by the figure below, the prefectures that follow Tirana with the largest percentage of dwellings and households were Fier, Elbasan, Durrës and Vlorë.

Vacant dwellings were 21.7 per cent of the conven-

Grafiku 12. Banesat e zakonshme të banuara dhe NjEF-të sipas qarqeve

Figure 12. Inhabited conventional dwellings and private households by prefecture



rurale. Banesat e destinuar për qëllime dytësore apo sezonale përbëjnë 8,3% të banesave të zakonshme dhe janë më të përqëndruara në zonat rurale, 52,3%. Ndër qarqet, Vlorë është qarku me numrin më të madh të banesave të pabanuara, 32,4% ndërsa shumica e banesave për qëllime dytësore dhe sezonale janë të shpërndara në Durrës, (16,5%), në

tional dwellings, of which 52.6 per cent were located in rural areas. Dwellings used for secondary or seasonal purposes were 8.3 per cent of the conventional dwellings and 52.3 per cent were in rural areas.


The prefecture of Vlorë has the largest percentage of vacant conventional dwellings, 32.4 per cent, whereas most of the dwellings used for secondary or

Vlorë, (14,6 %) dhe në Gjirokastrë, (12,6%).

Grafiku 13 pasqyron shpërndarjen sipas qarqeve të treguesit që shpreh përqindjen e banesave të zakonshme të pabanuara.

seasonal purposes were registered in the prefecture of Durrës, 16.5 per cent, the prefecture of Vlorë, 14.6 per cent and in the prefecture of Gjirokastrë, 12.6 per cent. The figure 13 shows the distribution of vacant conventional dwellings by prefecture.

Grafiku 13. Banesat e zakonshme të pabanuara sipas qarqeve
Figure 13. Vacant conventional dwellings by prefecture



Rreth 77% e banesave në Shqipëri kanë ujë të rrjedhshëm në banesë apo në ndërtesën në të cilën ndodhen. Në zonat urbane kjo përqindje është 90,9% e banesave në këto zona dhe në zonat rurale rreth 59% përkatësisht. Në nivel vendi, 85,2% e banesave kanë tualet me ujë të rrjedhshëm brenda banesës apo brenda ndërtesës. Në zonat urbane kjo përqindje është 96,2%, ndërsa në zonat rurale 71%. Më shumë se gjysma e banesave të banuara në Shqipëri kanë akses në të gjitha shërbimet bazë: sistem të furnizimit me ujë, tualet, dush/vaskë dhe ngrohje, ndërsa vetëm 1,1% e banesave të banuara në Shqipëri janë regjistruar pa asnjë akses në shërbimet bazë.

Në grafikun 14 janë pasqyruar përqindjet e banesave (të zakonshme ose jo) me akses në të gjitha shërbimet bazë.


Pjesa më e madhe e banesave (43,8%) kanë 3 dhoma, ndjekur nga banesat me 2 dhoma (28,7%) dhe banesat me 4 dhoma (17,9%). Dendësia standarde e banesave në nivel vendi është rreth 14m² për banorë. Qarku i Vlorës regjistron kuotën më të lartë të këtij treguesi, 16,39 m², ndërsa vlera më e vogël është regjistruar në qarkun e Kukësit, 10,49 m². Përqindja e banesave të mbipopulluara, banesa me 3 ose më shumë banorë për dhomë, është 3,74% në nivel vendi, me vlerën më të ulët 1,37% të regjistruar në qarkun e Gjirokastrës dhe vlerën më të lartë, 9,32 %, të regjistruar në qarkun e Kukësit.

